







Problema me 10 pikë

1. Albi ka 6 tullumbace. Ai dhuroi 2 nga tullumbacet e tij. Sa tullumbace i mbetën Albit?

- (A) 2      (B) 3      (C) 4      (D) 5      (E) 6




2. Cila nga pjesët e mëposhtme plotëson figurën?








3. Sa nga format e treguara janë trekëndësha?

- (A) 2  
(B) 3  
(C) 4  
(D) 5  
(E) 6




4. Në 5 rastet e mëposhtme secili këlysh kanguri po shkon te mamaja e vet duke kërcyer sipas rrugës së treguar. Cila nga këto rrugë është më e shkurtra?




5. Sa lapsa janë në figurën djathtas?

- (A) 7 (B) 8  
(C) 9 (D) 14  
(E) 16





6. Një katror i madh është formuar nga 16 katrorë të vegjël me të njëjtën madhësi. Më pas, katrorit të madh i janë hequr disa nga katrorë të vegjël, si në figurë. Sa katrorë të vegjël janë hequr?

- (A) 4 (B) 5  
(C) 6 (D) 7  
(E) 8




7. Në raftin e lodrave të Mishelit nuk ka breshka, lepuj dhe robotë. Cili nga këto rafte është rafti i Mishelit?




8. Të gjitha kopsat në pulovrën e Kaltrës kanë këtë formë:



Cila prej kopsave të mëposhtme është nga pulovra e saj?




9. Një grumbull me 18 kube mbështillet me dy shirita letre. Sa prej kubeve nuk preken nga asnjë shirit letre?



- (A) 6
- (B) 8
- (C) 9
- (D) 10
- (E) 12



10. Një dysheme është e mbuluar me pllaka katrore. Mbi dysheme janë shtruar ka 4 tapetë drejtkëndësh, si në figurë.





Sa pllaka mbulohen njëherësh nga 3 tapetë?

- (A) 0
- (B) 1
- (C) 2
- (D) 3
- (E) 4

11. Cili nga çelësat e mëposhtëm përshtatet me drynin e treguar në figurë?



12. Një qen ka 2 këlyshë me peshë të njëjtë. Në foton e parë tregohet se qeni bashkë me 1 këlysh peshon 14 kilogramë. Në foton e dytë tregohet se qeni me të dy këlyshët peshon 18 kilogramë.



Sa kilogramë peshon qeni?

- (A) 9 kilogramë (B) 10 kilogramë (C) 11 kilogramë (D) 12 kilogramë (E) 13 kilogramë







Problema me 3 pikë

1. Albi ka 6 tullumbace. Ai dhuroi 2 nga tullumbacet e tij. Sa tullumbace i mbetën Albit?

- (A) 2      (B) 3      (C) 4      (D) 5      (E) 6




2. Cila nga pjesët e mëposhtme plotëson figurën?




3. Sa nga format e treguara janë trekëndësha?

- (A) 2  
(B) 3  
(C) 4  
(D) 5  
(E) 6




4. Në 5 rastet e mëposhtme secili këlysh kanguri po shkon te mamaja e vet duke kërcyer sipas rrugës së treguar. Cila nga këto rrugë është më e shkurtra?




5. Sa lapsa janë në figurën djathtas?

- (A) 7 (B) 8  
(C) 9 (D) 14  
(E) 16




6. Një katror i madh është formuar nga 16 katrorë të vegjël me të njëjtën madhësi. Më pas, katrorit të madh i janë hequr disa nga katrorë të vegjël, si në figurë. Sa katrorë të vegjël janë hequr?

- (A) 4 (B) 5  
(C) 6 (D) 7  
(E) 8




7. Në raftin e lodrave të Mishelit nuk ka breshka, lepuj dhe robotë. Cili nga këto rafte është rafti i Mishelit?



8. Të gjitha kopsat në pulovrën e Kaltrës kanë këtë formë:




Cila prej kopsave të mëposhtme është nga pulovra e saj?




Problema me 4 pikë

9. Një grumbull me 18 kube mbështillet me dy shirita letre. Sa prej kubeve nuk preken nga asnjë shirit letre?



- (A) 6
- (B) 8
- (C) 9
- (D) 10
- (E) 12



10. Një dysheme është e mbuluar me pllaka katrore. Mbi dysheme janë shtruar ka 4 tapetë drejtkëndësh, si në figurë.




Sa pllaka mbulohen njëherësh nga 3 tapetë?

- (A) 0
- (B) 1
- (C) 2
- (D) 3
- (E) 4

11. Cili nga çelësat e mëposhtëm përshtatet me drynin e treguar në figurë?



12. Një qen ka 2 këlyshë me peshë të njëjtë. Në foton e parë tregohet se qeni bashkë me 1 këlysh peshon 14 kilogramë. Në foton e dytë tregohet se qeni me të dy këlyshët peshon 18 kilogramë.



Sa kilogramë peshon qeni?

- (A) 9 kilogramë (B) 10 kilogramë (C) 11 kilogramë (D) 12 kilogramë (E) 13 kilogramë

13. Në tavolinë ishin vendosur 12 fruta. Vera mori 2 dardha, 4 mollë dhe gjysmën e portokalleve. Tani në tavolinë kanë mbetur vetëm portokalle. Sa portokalle kanë mbetur?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 6


14. Në një radhë janë vendosur 12 nxënës. Valdrini është i pesti në radhë, nga e majta, ndërsa Ervini është i katërti në radhë, nga e djathta. Sa nxënës janë ndërmjet Valdrinit dhe Ervinit?



- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5








15. Dafina kishte tre libra në raft, siç tregohet në figurë.




- Në fillim, Dafina këmbëu librin e bardhë me librin gri.
- Pastaj Dafina këmbëu librin gri me librin e zi.


Si janë vendosur tani librat e Dafinës?








16. Figurat e mëposhtme tregojnë pamjen e përparme (ballore) dhe pamjen e pasme të një objekti të ndërtuar nga kube me ngjyra.



Objekti ndahet në tre pjesë. Dy nga pjesët janë paraqitur më poshtë.



Cila është pjesa e tretë?



Problema me 5 pikë

17. Në një varg rruazat e bardha dhe të zeza janë të vendosura njëra pas tjetrës.



Çdo bllok fsheh pesë rruaza. Sa rruaza të bardha janë fshehur gjithsej?

- (A) 5      (B) 6      (C) 7      (D) 9      (E) 10


18. Andi bleu 3 çokollata. Tomi bleu 5 çokollata. Tomi pagoi 800 lekë më shumë se Andi. Sa kushtoi 1 çokollatë?

- (A) 100 lekë      (B) 200 lekë      (C) 300 lekë      (D) 400 lekë      (E) 500 lekë

19. Kastrioti ka 5 lodra prej druri, siç tregohet në figurë.




Ai zgjedh 2 çifte lodrash në mënyrë që çiftet të peshojnë njësoj. Cila lodër nuk u zgjodh?




20. Shuma e moshës së Anës dhe Benit para 3 viteve ishte 6. Ana tani është 7 vjeç. Sa vjeç është Beni tani?

- (A) 1 vjeç      (B) 5 vjeç      (C) 6 vjeç      (D) 7 vjeç      (E) 11 vjeç

21. Çdo ngjitëse mollëkuqe (nusepashke) ka 1, 2, 3 ose 4 pika.




Armandi do të mbushë katrorët e formës së mëposhtme me ngjitëse në mënyrë që në çdo rresht dhe në çdo shtyllë të ketë mollëkuqe me numër të ndryshëm pikash.



Si do të duket rreshti i parë i formës kur Armandi ta përfundojë plotësimin e formës?




22. Në cepin e një dhome janë vendosur 13 kube (si në figurë). Secili kub ka ngjyrë të bardhë ose të zezë. Poshtë çdo kub të bardhë ndodhet një kub i zi, dhe poshtë çdo kub të zi ndodhet një kub i bardhë. Sa kube të bardhë janë vendosur në cepin e dhomës?



- (A) 4 (B) 6  
(C) 7 (D) 8  
(E) 9


23. Ilirjana vendos të lyejë çdo katror në formën e mëposhtme në mënyrë që katrorët e lyej me të njëjtën ngjyrë të mos jenë ngjitur njëri me tjetrin.



Ajo ngjyrosi 4 katrorë me të kuqe, 3 katrorë me blu, 2 katrorë me jeshile dhe 1 katror me të verdhë. Cila është ngjyra me të cilën ajo ngjyrosi katrorin e shënuar me X?

- (A) E kuqe (B) Blu (C) Jeshile (D) E verdhë  
(E) Nuk mund të përcaktohet


24. Sa herë që në makinë futet një monedhë, nga makina del një top nga rreshti i poshtëm në mënyrë të rastit. Cili është numri më i vogël i monedhave që duhet të fusë Besniku që ta ketë të sigurt që nga makina del një top i bardhë?



- (A) 6  
(B) 10  
(C) 11  
(D) 12  
(E) 15

Problema me 3 pikë

1. Majlinda bashkon kube të vegjël, duke i shtuar një nga një, për të ndërtuar një kub  $3 \times 3 \times 3$ . Ajo bëri foto në 5 momente të ndryshme. Cila do të jetë fotoja e katërt e Majlindës?




2. Simona shkruan katër shifrat 2, 0, 2, 5 në katër kutitë. Cila është radha që do t'i jepte asaj rezultatin më të madh?

$$\square + \square - \square + \square$$



- (A) 0, 2, 2, 5      (B) 0, 5, 2, 2      (C) 2, 5, 2, 0      (D) 5, 0, 2, 2      (E) 5, 2, 0, 2

3. Cili litar lidhet në një nyjë kur tërhiqen skajet?





4. Vlora rrotullon balonën e saj.


Cila nga figurat e mëposhtme paraqet balonën e saj?




5. Aleksandri eci mbi disa vija ngjitëse mbi tokë. Cila prej këpucëve ka gjurmët e vijave ngjitëse të shkelura?




6. Në një zar të rregullt, shumta e pikave në dy faqe të kundërta është gjithmonë 7. Cila nga figurat e mëposhtme paraqet një zar të rregullt?




7. Kanguri Keni shkon duke kërcyer nga shkolla në kopshtin zoologjik sipas udhëzimeve:  $\uparrow 2$ ,  $\nwarrow 2$ ,  $\swarrow 1$ ,  $\leftarrow 4$ , siç tregohet në figurë.



Më pas, ai shkon duke kërcyer nga kopshti zoologjik sipas udhëzimeve:  $\rightarrow 3$ ,  $\nearrow 2$ ,  $\uparrow 2$ . Në cilën shtëpi do të mbërrijë ai?




8. Cilën helikë mund të ndërtojë Joni me këto 3 shufra?



Problema me 4 pikë


9. Adi dhe motra e tij e vogël paguajnë me guaska dhe perla në dyqanin e tyre të lojërave. Çdo guaskë ka vlerën 6 dhe çdo perlë ka vlerën 1. Cili prej kombinimeve e ka vlerën 16?



10. Ana, Valbona dhe Glauk kanë në pjatat e tyre disa biskota në formë kanguri.




Më pas ata ndajnë 15 biskotat e mbetura në tabaka, në mënyrë që të gjithë të kenë të njëjtin numër biskotash në pjatat e tyre.



Sa biskota të tjera do të marrë Ana?


- (A) 4                      (B) 5                      (C) 6                      (D) 7                      (E) 8

11. Në mëngjes, 5 shokë kishin celularë të njëjtë, me bateritë e ngarkuara plotësisht. Deri në mbrëmje, Beni kishte folur në telefon me po aq njerëz sa Ana dhe Krista së bashku. Benit i mbaroi bateria. Davidi nuk e kishte përdorur fare telefonin e tij. Cili telefon i përkiste Edit?




- (A) 1                      (B) 2                      (C) 3                      (D) 4                      (E) 5

12. Cilat janë dy prej pjesëve të paraqitura më poshtë që plotësojnë tabelën e shahut?



- (A) 1 dhe 2                      (B) 1 dhe 5                      (C) 3 dhe 4  
 (D) 3 dhe 5                      (E) 4 dhe 5




13. Në kopshtin zoologjik, Rea ushqen 6 dele.

Ajo u jep atyre 210 gramë ushqim të thatë për drekë.

Ajo i jep deles më të vogël dy herë më shumë ushqim sesa i jep secilës prej të tjerave.

Sa ushqim merr delja më e vogël?



- (A) 55 gram      (B) 60 gram      (C) 70 gram      (D) 75 gram      (E) 80 gram


14. Tomi do të ndajë një picë në 2 pjesë.

Ai gjithashtu do që në secilën gjysmë të ketë të njëjtin numër domatesh.

Ai duhet ta bëjë këtë me dy prerje të ndryshme.

Sipas cilës dyshe vijash ai e pret picën?


- (A) 1 dhe 3      (B) 1 dhe 4  
 (C) 2 dhe 3      (D) 2 dhe 4  
 (E) 3 dhe 4



15. Maria shkruan mbi rrathë numrat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.


Numri në secilin nga rrathët e poshtëm është sa shuma e dy numrave në rrathët e lidhur me të.

Cili numër është shënuar në rrethin me shenjën ★?








- (A) 2      (B) 3      (C) 4      (D) 5      (E) 7

16. Blerimi formon një katror me 4 pjesë drejtkëndëshe, 3 nga të cilat paraqiten më poshtë.




Cila nga figurat e mëposhtme është pjesa e katërt që ai përdor?

- (A)       (B)       (C)   
 (D)       (E) 


Problema me 5 pikë

17. Mbi 6 mollëkuqe (nusepashke) janë 1, 2, 3, 4, 5 ose 6 pika. Margarita u bëri atyre 4 foto në grupe 3-she. Çdo mollëkuqe shfaqet në numër të njëjtë herësh në foto. Djathtas jepen 3 nga fotot, së bashku me skicën e fotos së katërt.




- (A) 9 (B) 10  
 (C) 11 (D) 12  
 (E) 23

18. Nela palos dy herë në mes një katror letrë, siç paraqitet në figurën më poshtë.




Më pas ajo pret disa copa nga letra e palosur.  
 Pasi e shpalos letrën, ajo sheh një flok dëbore prej letre.



Si e preu ajo letrën e palosur?

- (A) (B) (C) (D) (E)

19. Elona ka ndërtuar një piramidë duke përdorur kube me ngjyrë të zezë dhe gri. Ajo i vendos kubet në mënyrë të tillë që çdo faqe e një kubi të mos prekë faqe me të njëjtën ngjyrë të kubit tjetër. Një nga kubet me ngjyrë të zezë paraqitet në figurën djathtas. Cila do të jetë pamja nga lart e piramidës së Elonës?



- (A) (B) (C) (D) (E)



20. Më poshtë jepet faqja e një muaji të një kalendari, pa asnjë datë.

H	M	M	E	P	Sh	D

Shuma e datave të 2 ditëve të ngjyrosura është 29.


Në cilën ditë të javës bie dita e parë e muajit?

- (A) E hënë (B) E martë (C) E mërkurë  
 (D) E enjte (E) E diel

21. Për ndërtimin e mëposhtëm janë përdorur 11 tulla të njëjta.

Ky ndërtim është i gjatë 100 cm dhe i gjerë 60 cm.


Cilat janë përmasat e secilës tullë?



- (A) 8 cm 40 cm (B) 10 cm 40 cm (C) 12 cm 40 cm  
 (D) 8 cm 44 cm (E) 10 cm 50 cm

22. Në 5 provëza të njëjta janë vendosur topa të njëjtë, si në figurë.

Më pas, në secilën prej këtyre provëzave shtohet ujë.



Niveli i ujit në provëzat 1, 2 dhe 3 është i njëjtë.

Niveli e ujit në provëzat 4 dhe 5 është gjithashtu i njëjtë dhe dy herë më i lartë se në 3 provëzat e para.

Më pas nga provëzat hiqen topat.

Cila provëz ka më pak ujë?


- (A) Provëza 1 (B) Provëza 2 (C) Provëza 3  
 (D) Provëza 4 (E) Provëza 5

**23.** Roza ka shënuar numrin e frutave të ndryshme që ka. Fatkeqësisht, disa shifra janë mbuluar nga boja. Gjithsej, ajo ka 106 fruta. Numri i dy llojeve të frutave që ajo ka është i njëjtë. Ajo ka dy herë më shumë nga një lloj fruti sesa nga një lloj tjetër. Ajo ka më shumë se 10 fruta nga çdo lloj. Sa banane ka ajo?

- (A) 13                      (B) 23                      (C) 43  
(D) 53                      (E) 63

2	mango
0	molle
1	dardhe
3	banane
30	hurma
<hr/>	
106	

**24.** Dy peshore përdoren për të peshuar 3 objekte të ndryshme dhe rezultatet paraqiten më poshtë.




Objektet kanë pesha të ndryshme. Peshat mund të jenë 1, 2, 3, 4 ose 5 kg. Sa është pesha në kilogramë e një ■?

- (A) 1                      (B) 2                      (C) 3                      (D) 4                      (E) 5


Problema me 3 pikë

1. Cila nga pjesët e paraqitura do të plotësonte modelin?




- (A) (B) (C) (D) (E)

2. Ana ka ndërtuar një mur që tregon vitin 2025.  
Bela qëndron në anën tjetër të murit. Çfarë sheh Bela?



- (A) (B) (C) (D) (E)

3. Majk ka një fletëpalosje me numra dhe vrima në të dy anët, siç tregohet në figurë.




Ai palos anën e djathtë të fletës sipas vijës me ndërprerje dhe sheh numrat 2, 3, 5 dhe 6 përmes vrimave.

Pastaj ai palos anën e majtë të fletës sipas vijës me ndërprerje.  
Sa është shuma e numrave që ai sheh tani?


- (A) 10 (B) 12 (C) 14 (D) 9 (E) 8

4. Një kub është zbukuruar duke ngjitur katrorë të njëjtë me ngjyrë gri mbi të. Të gjitha faqet e kubit duken njësoj. Sa katrorë gri janë ngjitur në kub?



- (A) 30 (B) 18 (C) 16 (D) 15 (E) 14


5. Ema vendosi feta domate, ullinj të zinj, specja djegës, kërpudha dhe rrathë qepe mbi një picë, por jo domosdoshmërisht në këtë renditje. Çdo herë ajo vendosi vetëm një përbërës. Pica e saj e përfunduar është paraqitur në figurë.



Cili ishte përbërësi i tretë që ajo vendosi në picë?


- (A) feta domate (B) ullinj të zinj (C) specja djegës (D) kërpudha (E) rrathë qepe

6. Ena A mban 10 litra ujë. Të pesta vrimar në fund të enës A hapen në të njëjtën kohë dhe uji rrjedh poshtë. Sa është vëllimi i ujit që derdhet në enën B?



- (A) 3 litra (B) 4 litra  
 (C) 5 litra (D) 6 litra  
 (E) 8 litra

7. Antea rrotullon në drejtim të akrepave të orës një fletë letre të ndarë në gjashtë pjesë të barabarta. Fleta fillestare e letrës dhe rezultati i një rrotullimi tregohen në figurë. Si duket fleta e letrës pas tetë rrotullimeve të tilla?



8. Menuja e restorantit tim të preferuar për burger është e shkruar në një tabelë. Por shiu ka fshirë disa nga numrat. Burgerët janë renditur sipas çmimit. Cili është çmimi i një prej burgërve të mi?

- (A) 4.10 (B) 5.50 (C) 5.60 (D) 6.30 (E) 6.60

veggie	3.70
classic	.30
hot bacon	.60
cheesy	.50
double	.10
deluxe	6.80


9. Në një garë morën pjesë gjashtë fëmijë.

- Ariani përfundoi garën në vendin e tretë.
- Borisi përfundoi garën i gjashti, menjëherë pas Ernestit.
- Fatma përfundoi garën ndërmjet Arianit dhe Ernestit.
- Diana e kaloi Kristin tamam përpara vijës së finishit.

Kush e fitoi garën?

- (A) Ariani (B) Kristi (C) Diana (D) Ernesti (E) Fatma

10. Një bibliotekë librash me tre raftet ka 17 libra në raftin e sipërm, 15 libra në raftin e mesit dhe 7 libra në raftin e poshtëm. Monika dëshiron që të gjitha raftet të kenë numër të njëjtë librash. Ajo gjithashtu dëshiron të lëvizë sa më pak libra që të jetë e mundur. Sa libra duhet të lëvizë nga rafti i mesit në raftin e poshtëm?



- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5


Problema me 4 pikë

11. Në një garë prej 10 kilometrash marrin pjesë tre breshka. Secila prej tyre ecën me një shpejtësi konstante. Kur breshka e parë përfundon garën, breshka e dytë ka përshkuar  $\frac{1}{4}$  e distancës dhe breshka e tretë ka përshkuar  $\frac{1}{5}$  e distancës.

Sa larg nga vija e finishit do të jetë breshka e tretë kur breshka e dytë të përfundojë garën?


- (A) 1 km (B) 2 km (C) 3 km (D) 4 km (E) 5 km

12. Vera ka ndërtuar një kullë me blloqe. Ajo dëshiron të zëvendësojë dy blloqet me pikëpyetjet me dy blloqe me numra. Ajo dëshiron që numri në çdo bllok në kullën e saj të jetë të paktën 2 më shumë se numri në bllokun poshtë tij. Në sa mënyra mund ta bëjë Vera këtë?





- (A) 3 (B) 4 (C) 5  
(D) 6 (E) 7

13. Figura tregon pesë rrota të fatit. Çdo rrotë është e ndarë në një numër të ndryshëm pjesësh të njëjta. Lojtari rrotullon rrotën dhe fiton një çmim kur pjesa e zezë e rrotës ndalon nën shigjetë (trekëndëshi i vogël). Cila rrotë ju jep mundësinë më të mirë për të fituar?



- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

14. Cila formë, ose ndonjë rrotullim i saj, nuk mund të vendoset sipër kuadrateve të bardha të katrorit të madh?




15. Ekipi i notit i shkollës sime po stërvitet për një garë me stafeta. Pesë notarë notuan të njëjtën distancë, njëri pas tjetrit. Figurat më poshtë tregojnë kohën në kronometrin e trajnerit të tyre kur secili notar përfundoi stafetën e tij. Notarit të parë iu deshën 2 minuta e 8 sekonda. Cili prej notarëve notoi më shpejt?



- (A) i pari (B) i dyti (C) i treti (D) i katërti (E) i pesti

16. Jona pret katër katrorë të njëjtë nga cepat e një fletë letre katrore, siç tregohet në figurë. Syprina e përgjithshme që ajo preu është  $16 \text{ cm}^2$  dhe syprina e kryqit që mbetet është  $9 \text{ cm}^2$ . Sa cm është perimetri i kryqit?



- (A) 9 (B) 16 (C) 20 (D) 25 (E) 32

17. Në secilën prej kartave të paraqitura më poshtë janë shkruar dy numra 3-shifrorë, por disa nga shifrat nuk mund të shihen pasi i ka mbuluar boja. Në njërën nga kartat, shuma e shifrave të të dy numrave është e njëjtë. Në cilën kartë janë këta dy numra?

(A) 543 dhe 11


(B) 58 dhe 11

(C) 982 dhe 1

(D) 211 dhe 6

(E) 777 dhe 2

18. Forma në diagram është ndërtuar nga katrorë të njëjtë. Pika B është në gjysmë të rrugës midis pikave A dhe C. Gjithashtu, pika D është në gjysmë të rrugës ndërmjet pikave C dhe E. Marta dëshiron ta ndajë formën në dy pjesë me syprina të barabarta. Cilën nga pikat A, B, C, D ose E duhet ta bashkojë me një vijë të drejtë me pikën S për ta realizuar këtë?



(A) A


(B) B

(C) C

(D) D

(E) E

19. Hergji dëshiron të shkruajë një 0 ose një 1 në secilën kuti të diagramit në mënyrë që shuma e numrave në çdo rresht, kolonë dhe diagonale të jetë 3. Ai tashmë ka shkruar një 0 në njërën nga kutitë.



Kur të mbarojë, sa do të jetë shuma e numrave në kutitë me shenjën e pikëpyetjes?

(A) 1

(B) 2

(C) 3

(D) 4

(E) Nuk mund të llogaritet.

20. Mira dhe Arturi shkruan secili tre numra 3-shifrorë duke përdorur shifrat 1 deri në 9 vetëm një herë. Pastaj ata renditën numrat e tyre nga më i vogli te më i madhi. Mira shkroi vlerën më të madhe të mundshme që mund të kishte numri i mesëm. Arturi shkroi vlerën më të vogël të mundshme që mund të kishte numri i mesëm. Sa është ndryshesa midis dy numrave të tyre të mesit?

(A) 642

(B) 684



(C) 864

(D) 888

(E) asnjë nga ato më parë

Problema me 5 pikë

21. Një magjistar kishte 10 mollë, 9 banane dhe 6 dardha. Një ditë ai bëri disa magji dhe e ktheu secilën prej frutave të tij në një nga dy llojet e tjera. Për shembull, ai ktheu çdo mollë ose në një banane ose në një dardhë. Ai tani ka 15 mollë, 7 banane dhe 3 dardha. Sa nga mollët i ktheu në banane?



(A) 3


(B) 4

(C) 5

(D) 6


(E) 7

22. Gjatësia e brinjës së katrorit të paraqitur në diagram është 10 cm. Vija vertikale në mes të katrorit e ndan atë në dy drejtkëndësha të barabartë. Sa është syprina e zonës gri?



- (A)  $12.5 \text{ cm}^2$  (B)  $25 \text{ cm}^2$  (C)  $30 \text{ cm}^2$  (D)  $40 \text{ cm}^2$  (E)  $50 \text{ cm}^2$

23. Ejona e ndan figurën e treguar në pesë pjesë me forma të njëjta, ku secila formë përbëhet nga tre katrorë. Cila është shkronja që ndodhet në formën që përmban yllin?



- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E

24. Fatjoni nuk e thotë kurrë të vërtetën të martën, të enjten dhe të shtunën. Ai gjithmonë thotë të vërtetën në katër ditët e tjera.

Një ditë Mateo zhvilloi bisedën e mëposhtme me Fatjonin:

Mateo: “Çfarë dite është sot?”

Fatjoni: “E shtunë”


Mateo: “Çfarë dite do të jetë nesër?”

Fatjoni: “E mërkurë”

Në cilën ditë u zhvillua kjo bisedë?

- (A) E hënë (B) E martë (C) E mërkurë (D) E enjte (E) E premte

25. Juli dëshiron të ndërtojë këtë formë kryqi të treguar në figurë duke përdorur pjesë të formës së tyre si ato poshtë kryqit. Ai ka shumë kopje të secilës pjesë dhe e di se mund t’i rrotullojë ato nëse është e nevojshme. Pjesët nuk duhet të mbivendosen.




Cili është numri më i vogël i pjesëve që përdor ai për të ndërtuar formën?



- (A) 11 (B) 12 (C) 13  
(D) 15 (E) 17


26. Disa blloqe janë vendosur në ekuilibër njëri mbi tjetrin, siç tregohet në figurë. Blloqet me pamje të njëjtë kanë të njëjtën peshë.



Vjola dëshiron të rendisë tre llojet e ndryshme të blloqeve katrore, nga më i rëndi te më i lehti. Cila është renditja që dëshiron Vjola?

- (A) (B) (C)   
(D) (E)


27. Arba dëshiron të shkruajë një numër, nga 1 deri në 9, në katrorët në diagramë në mënyrë që shuma e numrave në çdo dy katrorë fqinj të jetë sa numri i treguar në vijën që bashkon këta katrorë.








Sa është shuma e numrave që ajo shkruan në rreshtin e mesit (me ngjyrë gri)?


- (A) 16                      (B) 17                      (C) 18                      (D) 20                      (E) 21

28. Tomi kombinon tre blloqet e ndërtimit të paraqitur në të djathtë. Cilin nga trupat e mëposhtme formoi ai?




- (A)  (B)  (C)  (D)  (E) 

29. Sara kishte tre herë më shumë çokollata se Sonila. Sara më pas i dha një të katërtën e çokollatave së saj Sonilës. Sara tani ka gjashtë çokollata më shumë se Sonila. Sa çokollata më shumë se Sonila kishte Sara në fillim?



- (A) 36                      (B) 30                      (C) 27                      (D) 24                      (E) 20

30. Zana dëshiron të blejë disa lule. Çmimet e tre luleve (në euro) që ajo mund të blejë janë paraqitur në figurë. Sa buqeta të ndryshme me vlerë të përgjithshme saktësisht 23 (euro) mund të blejë ajo?



- (A) 4                      (B) 5                      (C) 6                      (D) 7                      (E) 8




Problema me 3 pikë

1. Liza ka katër shifra prej druri. Ajo mund t'i përdorë për të formuar numrin 2025. Cili nga numrat e mëposhtëm është më i madhi që mund të formojë ajo me këto shifra?

2 0 2 5


- (A) 2502      (B) 5202      (C) 5220      (D) 5502      (E) 5520

2. Izabela e rrotullon gjashtëkëndëshin e letrës, në drejtimin e akrepave të orës, me të njëjtit kënd, siç tregohet në figurë. Cili nga numrat e mëposhtëm të rrotullimeve do ta kthente fletën në të njëjtin pozicion si në fillim?




- (A) 7      (B) 8      (C) 9      (D) 10      (E) 12

3. Sandra hedh tre zare dhe shuma e pikëve të rëna është 8. Të tre zaret tregojnë një numër të ndryshëm pikash. Cili numër pikash nuk mund t'i bjerë Sandrës në ndonjë prej zareve të saj?



4. Gjashtëkëndëshi i rregullt i paraqitur në të djathtë është ndarë në shumë trekëndësha me syprina të barabarta. Ç'pjesë e gjashtëkëndëshit përbën pjesa në gri?



- (A)  $\frac{1}{2}$       (B)  $\frac{1}{3}$   
 (C)  $\frac{1}{4}$       (D)  $\frac{1}{5}$   
 (E)  $\frac{1}{6}$


5. Sa periudha 12 minutëshe ka në 12 orë?

- (A) 60      (B) 24      (C) 12      (D) 10      (E) 6

6. Danieli është 5 vjeç. Vëllai i tij Drini është 6 vjet më i madh. Sa do të jetë shuma e moshave të tyre pas 7 vitesh?

- (A) 26      (B) 27      (C) 28      (D) 29      (E) 30

7. Olsi dëshiron të shkruajë katër shifrat 2, 0, 2 dhe 5 në katër kutitë djathtas. Cili është rezultati më i vogël që merr Olsi?




- (A) -7      (B) -6      (C) -5      (D) -4      (E) -3

8. Në një dhomë numri i personave që thonë të vërtetën është dhjetë më shumë se ata që nuk thonë të vërtetën. Secili prej tyre u pyet: “A thua të vërtetën?” dhe secili dha një përgjigje. “Po” u përgjigjën gjithsej 20 persona. Sa persona nuk thonë të vërtetën?

- (A) 0      (B) 5      (C) 15      (D) 20      (E) 25

9. Pesë rrahë, secili me syprinë  $8 \text{ cm}^2$ , mbivendosen për të formuar figurën e treguar. Syprina e çdo zone ku dy rrahë mbivendosen është  $1 \text{ cm}^2$ .




Sa është syprina e përgjithshme e mbuluar nga figura?

- (A)  $32 \text{ cm}^2$       (B)  $36 \text{ cm}^2$       (C)  $38 \text{ cm}^2$       (D)  $39 \text{ cm}^2$       (E)  $42 \text{ cm}^2$

10. Kombinimi i vërtetë për kodin e bllokimit të biçikletës është 0000, siç tregohet në figurë. Por, kur dikush e shikon atë, atij i duket si 8888.

Kur Arbri e shikon kombinimin e kodit të shokut të tij, atij i duket si 2815.

Cili është kombinimi i vërtetë i kodit të shokut të tij?




- (A) 4037      (B) 4693      (C) 0639      (D) 0693      (E) 9603

Problema me 4 pikë

11. Miu Martin dëshiron të arrijë në një prej copave të djathit. Ai lëviz vetëm horizontalisht ose vertikalisht ndërmjet çdo dy kutive në drejtimet e treguara nga shigjetat.

Sa rrugë të ndryshme mund të ndjekë Martini për të arritur një copë djathë?




- (A) 3      (B) 5  
(C) 8      (D) 10  
(E) 11

12. Në një garë 60 m me pengesa ka pesë të tilla. Pengesa e parë është pas 12 m. Distanca ndërmjet çdo dy pengesave të njëpasnjëshme është 8 m.

Sa larg është pengesa e fundit nga vija e finishit?


- (A) 16 m      (B) 14 m      (C) 12 m      (D) 10 m      (E) 8 m

13. Eduardi dëshiron të shkruajë një numër në çdo rreth në diagram. Ai dëshiron që çdo numër të jetë i barabartë me shumën e numrave në dy rrahët ngjitur. Ai ka shkruar tashmë dy numra, siç tregohet në figurë. Çfarë numri duhet të shkruajë ai në rrethin gri?



- (A) 2      (B) -1      (C) -2  
(D) -3      (E) -5

14. Luani vendos tre fotografi drejtkëndëshe në mënyrën e treguar më poshtë. Sa është vlera e këndit  $x$ ?



- (A) 64                      (B) 70                      (C) 72                      (D) 76                      (E) 80

15. Besniku ndodhet në një pistë vrapimi në një palestër. Ai e mat kohën me dy kronometra, ku i pari tregon kohën e kaluar që nga fillimi i seancës së tij, ndërsa i dyti kohën e mbetur deri në fund të seancës së tij.



Në një moment, dy kronometrat tregojnë të njëjtën kohë. Sa është koha që tregojnë ato në atë moment?

- (A) 17:50                      (B) 18:00                      (C) 18:12  
(D) 18:15                      (E) 18:20

16. Jona dëshiron të plotësojë çdo  me një numër të thjeshtë të ndryshëm më të vogël se 20 në mënyrë që vlera  $A$  të jetë numër natyror.


Cila është vlera maksimale e  $A$ ?

$$A = \frac{\square + \square + \square + \square + \square + \square + \square}{\square}$$

- (A) 20                      (B) 14                      (C) 10                      (D) 8                      (E) 6


17. Martini dëshiron të plotësojë kuadratet në diagramën e treguar në mënyrë që çdo kuadrat të përmbajë ose një kryq ose një rreth. Ai gjithashtu dëshiron të sigurohet se nuk ka katër simbole të njëjta të njëpasnjëshme në asnjë kolonë, rresht ose diagonale.

Kur ta ketë përfunduar diagramin, çfarë do të përmbajë kolona me ngjyrë gri?



- (A) 3 rrethë dhe 3 kryqe                      (B) 2 rrethë dhe 4 kryqe  
(C) 4 rrethë dhe 2 kryqe                      (D) 5 rrethë dhe një kryq  
(E) një rreth dhe 5 kryqe

18. Në drejtkëndëshin  $ABCD$  pikat  $E$  dhe  $F$  ndodhen në brinjën  $CD$  të tilla që  $\angle EBA = \angle DFA = 45^\circ$  dhe  $AB + EF = 20$  cm. Sa është gjatësia e  $BC$ ?




- (A) 4 cm      (B) 6 cm      (C) 8 cm      (D) 10 cm      (E) 12 cm

19. Sibora ka dy kosha me topa të numëruar. Koshi X përmban shtatë topa me numrat 1, 2, 6, 7, 10, 11 dhe 12. Koshi Y përmban pesë topa me numrat 3, 4, 5, 8 dhe 9. Cilin top duhet të transferojë Sibora nga koshi X në koshin Y që të rrisë mesataren e numrave në të dy koshat?

- (A) 6                      (B) 7                      (C) 10                      (D) 11                      (E) 12

20. Valdrini ka vizatuar një çerek rrethi me qendër në çdo cep të një flamuri me përmasa 12 cm me 9 cm dhe ka ngjyrosur zonën e formuar, siç tregohet në figurë. Sa është gjatësia e segmentit me shenjë e pikëpyetjes?



- (A) 5 cm                      (B) 6 cm                      (C) 7 cm                      (D) 8 cm                      (E) 9 cm

Problema me 5 pikë

21. Në numrin natyror gjashtëshifror  $PAPARA$ , shkronja të ndryshme përfaqësojnë shifra të ndryshme dhe e njëjta shkronjë përfaqëson gjithmonë të njëjtën shifër. Gjithashtu  $R = P + P = A + A + A$ .

Sa është vlera e  $P \times A \times P \times A \times R \times A$ ?

- (A) 432                      (B) 342                      (C) 324                      (D) 243                      (E) 234

22. Gjatë dy seancave të stërvitjes në futboll, Arjani godet gjithsej 17 herë portën. Saktësia e goditeve në shenjë në seancën e parë është 60%, ndërsa në seancën e dytë është 75% e goditjeve. Sa herë Arjani e goditi portën në shenjë në seancën e dytë?


- (A) 6                      (B) 7                      (C) 8                      (D) 9                      (E) 10

23. Armandi niset gjithmonë për në shkollë në orën 8:00 të mëngjesit. Shkolla e tij është 1 km larg. Kur shkon në shkollë në këmbë, shpejtësia e tij është 4 km/h. Kur shkon me biçikletë, shpejtësia e tij është 15 km/h. Kur shkon me këmbë ai mbërrin 5 minuta më herët. Sa minuta më herët mbërrin ai në shkollë kur shkon me biçikletë?

- (A) 12                      (B) 13                      (C) 14                      (D) 15                      (E) 16

24. Hana vizaton katër katrorë, siç tregohet në figurë. Sa është syprina e katërkëndëshit gri?

- (A) 54
- (B) 60
- (C) 66
- (D) 72
- (E) 80




25. Shkronjat  $p, q, r, s$  dhe  $t$  paraqesin pesë numra natyrorë të njëpasnjëshëm, megjithëse jo domosdoshmërisht në këtë radhitje. Shuma e  $p$  dhe  $q$  është 69 dhe shumën e  $s$  dhe  $t$  është 72. Sa është vlera e  $r$ ?


- (A) 29
- (B) 31
- (C) 34
- (D) 37
- (E) 39

26. Kur lartësia e një kuboidi zvogëlohet me 3 cm, syprina e tij zvogëlohet me  $60 \text{ cm}^2$ . Forma që rezulton është një kub. Sa  $\text{cm}^3$  është vëllimi i kuboidit fillestar?

- (A) 75
- (B) 125
- (C) 150
- (D) 200
- (E) 225



27. Në katërkëndëshin  $ABCD$ , pikat  $N$  dhe  $K$  ndodhen përkatësisht në brinjët  $BC$  dhe  $AD$  në mënyrë që  $BN = 2NC$  dhe  $AK = KD$ . Syprina e trekëndëshit  $CKD$  është 2 dhe syprina e trekëndëshit  $ABN$  është 6. Sa është syprina e katërkëndëshit  $ABCD$ ?




- (A) 13
- (B) 14
- (C) 15
- (D) 16
- (E) 17

28. Disa zogj, ndërmjet të cilëve janë edhe H, L, N dhe T, janë ulur në katër tela paralele. Mbi H qëndrojnë 10 zogj, mbi L 25 zogj, ndërsa poshtë N pesë zogj dhe poshtë T qëndrojnë 2 zogj. Numri i zogjve të ulur mbi T është shumëfish i numrit të zogjve të ulur poshtë tij. Sa zogj janë ulur në të katër telat?

- (A) 27
- (B) 30
- (C) 32
- (D) 37
- (E) 40


29. Figura e djathtë e mëposhtme tregon hapjen e trupit të një tetëfaqëshi. Çdo faqe e këtij trupi është e ndarë në tre pjesë. Tetëfaqëshi ngjyrosset me tre ngjyra: e zezë, gri e errët dhe gri e lehtë në mënyrë të tillë që pjesët që dalin nga i njëjti kulm ose nga një kulm i kundërt të kenë të njëjtën ngjyrë. Me çfarë ngjyre ngjyrosset pjesa që përmban pikën?




- (A) Vetëm e zezë                      (B) Vetëm gri e errët                      (C) Vetëm gri e lehtë  
 (D) Janë të mundshme e zeza dhe grija e errët.  
 (E) Janë të mundshme e zeza dhe grija e lehtë.

30. Arta ruan perlat e arta, të kuqe, të zeza, rozë dhe të bardha në pesë kuti të vogla. Çdo kuti përmban perla vetëm të një ngjyre. Kutitë janë emërtuar siç tregohet në figurë dhe të gjitha emërtimet janë të vërteta. Lulja, mikja e Artës, dëshiron të dijë se cila kuti përmban perlat e arta. Ajo mund të hapë vetëm një nga pesë kutitë për të parë perlat.


Cilën kuti duhet të hapë Lulja që të jetë e sigurt se cila nga kutitë përmban perlat e arta?




(A) e artë ose e kuqe




(B) rozë ose e zezë



(C) e zezë ose e artë



(D) jo e zezë



(E) rozë ose e bardhë

Problema me 3 pikë

1. Fletëpalosja e paraqitur në të djathtë përmban dritare transparente, që lejon të shihet qartë ajo që ndodhet poshtë saj, kur mbyllet. Sa është shumja e numrave që shihen poshtë dritareve, kur mbyllen të dyja kanatat?


□	□	□	4	9	2	□	□
□	□	□	3	5	7	□	□
□	□	□	8	1	6	□	□

- (A) 7                      (B) 9                      (C) 12                      (D) 14                      (E) 15

2. Baza e një trekëndëshi rritet me 50% dhe lartësia e tij zvogëlohet me një të tretën. Cili është raporti i syprinës së trekëndëshit të ri me atë të trekëndëshit fillestar?

- (A) 2:1                      (B) 1:1                      (C) 1:2                      (D) 1:3                      (E) 1:4

3. Në cilin nga gjashtëkëndëshat e mëposhtëm syprina e zezë është sa një e treta dhe ajo e bardhë është sa gjysma e syprinës së përgjithshme?



4. Dita e Kangurit mbahet çdo vit të enjten e tretë të marsit. Cila datë është dita më e hershme e mundshme për Ditën e Kangurit?

- (A) 14/3                      (B) 15/3                      (C) 20/3                      (D) 21/3                      (E) 22/3

5. Një recetë kërkon 1 gotë oriz dhe  $1\frac{1}{2}$  gotë ujë. Luani dëshiron të përdorë  $1\frac{1}{2}$  gotë oriz. Sa gota ujë i duhen atij?


- (A) 1                      (B)  $1\frac{1}{4}$                       (C)  $1\frac{3}{4}$                       (D)  $2\frac{1}{4}$                       (E)  $2\frac{1}{2}$

6. Linda ka katër shifra prej druri. Ajo mund t'i përdorë ato për të formuar numrin 2025. Sa numra të ndryshëm më të mëdhenj se 2025 mund të formojë me këto shifra?



- (A) 3                      (B) 6                      (C) 8                      (D) 9                      (E) 11

7. Aleksandri palos një katror sipas diagonales për të formuar një trekëndësh. Pastaj e palos letrën përsëri në mënyrë që njëra nga brinjët më të shkurtra të këtij trekëndëshi t'i mbivendoset hipotenzës së këtij trekëndëshi, duke e bërë trekëndëshin më të vogël  $AXC$ , siç tregohet në rastin e figurës në të djathtë. Sa është masa e këndit  $AXC$ ?



- (A)  $108^\circ$                       (B)  $112.5^\circ$                       (C)  $120^\circ$                       (D)  $145^\circ$                       (E)  $157.5^\circ$

8. Numrit 4-shifror  $80\square\square$  i mungojnë dy shifrat e fundit. Numri pjesëtohet me 8 dhe 9. Sa është prodhimi i këtyre dy shifrave që mungojnë?


- (A) 6                      (B) 16                      (C) 20                      (D) 24                      (E) 48

9. Luka ka disa qen, disa lepuj dhe disa mace. Tetë nga kafshët e tij shtëpiake nuk janë qen. Pesë nga kafshët e tij shtëpiake nuk janë lepuj. Shtatë nga kafshët e tij shtëpiake nuk janë mace. Sa kafshë shtëpiake ka Luka?

- (A) 10                      (B) 11                      (C) 15                      (D) 16                      (E) 20


10. Jepet rrethi me qendër  $O$  dhe me rreze 10 cm. Brenda rrethit vizatohet katrori  $OPQR$ , ku  $Q$  është një pikë në rreth. Sa është syprina e trekëndëshit  $PQR$ ?

- (A)  $12.5 \text{ cm}^2$     (B)  $25 \text{ cm}^2$     (C)  $50 \text{ cm}^2$     (D)  $75 \text{ cm}^2$     (E)  $100 \text{ cm}^2$



Problema me 4 pikë


11. Një atlet ka një koleksion prej dy medaljesh ari dhe pesë argjendi. Atyre u janë vendosur numrat nga 1 në 7, në një rend të caktuar. Figura paraqet fotot bardh e zi të medaljeve. Dihet se në çdo foto, një nga medaljet është ari. Sa është shuma e numrave të dy medaljeve të arta?



- (A) 7                      (B) 8                      (C) 9                      (D) 10                      (E) 11

12. Ana shikon një foto në celularin e saj. Formati është  $16 : 9$  dhe zë të gjithë ekranin. Kur ajo e rrotullon telefonin, fotoja bëhet më e vogël. Çfarë pjese të sipërfaqes së ekranit zë fotoja më e vogël?

- (A)  $\frac{3}{4}$                       (B)  $\frac{9}{16}$                       (C)  $\frac{27}{64}$                       (D)  $\frac{32}{81}$                       (E)  $\frac{81}{256}$




13. Kaltrina dhe Tomi sot festojnë datëlindjen. Tomi vëren se  $\frac{1}{19}$  e moshës së Kaltrinës është sa  $\frac{1}{17}$  e moshës së tij. Shuma e moshave të tyre është më e madhe se 40 dhe më e vogël se 100. Sa vjeç është Kaltrina?

- (A) 19                      (B) 34                      (C) 38                      (D) 57                      (E) 76

14. Pëllumbi shtiu 27 herë me shigjetë në dy objektiva. Saktësia e goditjes në shenjestrën e objektivit në të majtë lart është 50%, ndërsa në objektivin e poshtëm djathtas është 80% e të shtënave. Ai humbet gjithsej 9 të shtëna. Sa herë e goditi ai objektivin majtas lart?

- (A) 4                      (B) 5                      (C) 6                      (D) 7                      (E) 8




15. Sara ka një çantë me 18 topa, me numrat nga 1 deri në 18. Cili është numri më i vogël i topave që Sara duhet të heqë për të qenë e sigurt se ka hequr të paktën tre topa me numra të thjeshtë?

- (A) 11                      (B) 12                      (C) 13                      (D) 14                      (E) 15



16. Davidi dëshiron të vendosë në secilën kuti të diagramit numrat nga 1 deri në 8. Ai dëshiron që kutitë që përmbajnë numra të njëpasnjëshëm të mos kenë asnjë brinjë ose kulm të përbashkët. Cilët numra mund të vendosë Davidi në kutinë e shënuar me  $X$ ?




- (A) 1 ose 8      (B) 2 ose 7      (C) 3 ose 6      (D) 4 ose 5  
(E) 7 ose 8

17. Numri i plotë  $N$  është numri më i madh gjashtëshifror i plotë që e ka prodhimin e të gjitha shifrave të tij 180. Sa është shuma e shifrave të  $N$ ?

- (A) 21      (B) 22      (C) 23      (D) 24      (E) 25

18. Dy drejtkëndëshat gri janë kongruentë dhe secili e ka syprinën 4. Sa është syprina e drejtkëndëshit të madh  $ABCD$ ?


- (A) 10      (B)  $8\sqrt{3}$       (C) 8  
(D) 12      (E)  $4\sqrt{3}$



19. Prodhimi i tre numrave të thjeshtë është 11-fishi i shumës së tyre. Gjeni vlerën më të madhe të mundshme të shumës së tyre.

- (A) 14      (B) 17      (C) 21      (D) 25      (E) 26

20. Pesë tulla vendosen në tokë, siç tregohet në figurë. Sokoli mund të heqë një tullë vetëm nëse nuk ka tulla sipër saj. Ai zgjedh një nga tullat e disponueshme në mënyrë të rastit dhe e heq atë, derisa të hiqen të gjitha tullat. Sa është probabiliteti që tulla me numër 4 të jetë tulla e tretë që hiqet?




- (A)  $\frac{1}{3}$       (B)  $\frac{1}{4}$       (C)  $\frac{1}{5}$       (D)  $\frac{1}{6}$       (E)  $\frac{1}{8}$

Problema me 5 pikë

21. Katrori  $ABCD$  përmban dy drejtkëndësha. Njëri është gri dhe tjetri me vija, me përmasa siç tregohet në diagram (nuk janë në përmasa reale). Syprina e pjesës së mbivendosur të dy drejtkëndëshave është  $18 \text{ cm}^2$ . Sa është perimetri i  $ABCD$ ?

- (A) 28 cm      (B) 34 cm      (C) 36 cm  
(D) 38 cm      (E) 40 cm




22. Një numër i plotë katërshifror  $\overline{ABCD}$  shumëzohet me shifrën e njësheve të tij  $\overline{D}$ . Rezultati është një numër tjetër i plotë katërshifror  $\overline{DXYA}$ , që ka njëshet dhe mijëshet shifrat e numrit të plotë fillestar të ndërruara. Sa numra të plotë katërshifror  $\overline{ABCD}$  e kanë këtë veti?

$$\begin{array}{r} A B C D \\ \times \quad D \\ \hline D X Y A \end{array}$$

- (A) 1      (B) 2      (C) 9      (D) 10      (E) 11

23. Danieli numëron disa katrorë në një fletë letre me kuadrate. Çdo katror e ka gjatësinë e brinjës 0,5 cm. Ai fillon me një katror dhe më pas numëron katrorët 2, 3, 4, 5, ... në drejtim të kundërt të akrepave të orës, siç tregohet në diagram. Ai ndalon kur ka numëruar 2025 katrorë dhe shikon formën e përbërë nga të gjithë katrorët e numëruar. Sa është perimetri i kësaj forme?




- (A) 25 cm (B) 45 cm (C) 80 cm (D) 90 cm (E) 180 cm

24. Me shifrat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 është një numër i plotë gjashtëshifror  $\overline{ABCDEF}$ . Numri i formuar me dy shifrat e para të tij  $\overline{AB}$  është shumëfish i 2, ai me tre shifrat e para  $\overline{ABC}$  është shumëfish i 3, ai me katër shifrat e para  $\overline{ABCD}$  është shumëfish i 4, ai me pesë shifrat e para  $\overline{ABCDE}$  është shumëfish i 5 dhe gjithë numri i plotë  $\overline{ABCDEF}$  është shumëfish i 6. Cila është shifra e gjashtë,  $F$ ?

- (A) 2 (B) 4 (C) 6  
(D) kanë mundësi 2 dhe 4 (E) kanë mundësi 4 dhe 6

25. Në diagram, diametri i rrethit të brendshëm është pjesë e diametrit të rrethit të jashtëm. Rrethi i jashtëm ka një kordë me gjatësi 16 që është paralele me diametrin e tij dhe është gjithashtu tangjent me rrethin e brendshëm. Sa është syprina e zonës gri?




- (A)  $36\pi$  (B)  $49\pi$  (C)  $64\pi$  (D)  $81\pi$   
(E) Nuk mjafton informacioni i dhënë.

26. Vargu i numrave  $a_1, a_2, a_3, a_4, \dots, a_{10}$  është i tillë që nga termi i tretë e në vazhdim, çdo term është i barabartë me mesataren e të gjithë termave para tij. Kjo do të thotë, se  $a_3$  është sa mesatarja e  $a_1$  dhe  $a_2$ ,  $a_4$  është sa mesatarja e  $a_1, a_2$  dhe  $a_3$ , e kështu me radhë. Në këtë varg  $a_1 = 8$  dhe  $a_{10} = 26$ . Sa është vlera e  $a_2$ ?

- (A) 28 (B) 32 (C) 38 (D) 44 (E) 50

27. Gjashtë rrathë janë vendosur në formën e një trekëndëshi, siç tregohet në figurë. Adriatiku i shkruan shifrat nga 1 deri në 6 brenda rrathëve në mënyrë që shumatat e numrave në rrathët në të tre brinjët e këtij trekëndëshi të jenë të njëjta. Më pas ai llogarit shumën e numrave në tre rrathët në kulmet e trekëndëshit. Sa vlera të mundshme merr ai për këtë shumë?




- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

28. Në një festë, marrin pjesë dymbëdhjetë fëmijë, duke përfshirë tre çifte binjakë. Sa mënyra ka për t'u shpërndarë fëmijëve gjashtë kapele blu dhe gjashtë kapele të kuqe, në mënyrë që në secilin çift binjakësh, të dy fëmijët të mbajnë kapele të së njëjtës ngjyre?

- (A) 72 (B) 86 (C) 92 (D) 102 (E) 132


29. Trekëndëshi  $ABC$  e ka syprinën 60. Pika  $I$  është mesi i brinjës  $BC$  dhe pikat  $J$  e  $K$  ndajnë brinjën  $AC$  në tre segmente të barabarta. Pika  $L$  është pikëprerja e  $AI$  dhe  $BJ$ . Gjeni syprinën e trekëndëshit  $ALJ$ .

- (A) 4      (B) 5      (C) 6      (D) 7      (E) 8



30. Anastasia dëshiron të shkruajë numrat nga 1 në 8 në kuadratet e një table  $2 \times 4$ . Numri në çdo kuadrat duhet të jetë më i vogël se numri në kuadratin në të djathtë të tij dhe më i vogël se numri në kuadratin poshtë tij. Në sa mënyra të ndryshme Anastasia e mbush tabelën?

- (A) 6      (B) 8      (C) 10      (D) 12      (E) 14




Problema me 3 pikë

1. Viti 2025 është një katror i përsosur sepse  $2025 = 45^2$ . Sa vite duhet të kalojnë deri në vitin tjetër të ardhshëm që është katror i përsosur?

- (A) 25                      (B) 91                      (C) 121                      (D) 500                      (E) 2025

2. Një nxënës hodhi pesë gurë, njëri pas tjetrit, të cilët goditën një dritare në pikat  $A, B, C, D$  dhe  $E$ . Aty ku guri godet xhamin krijon disa çarje lineare të cilat ndalojnë ose në një çarje të mëparshme ose në kontur. Në cilën radhë i hodhi gurët nxënësi?



- (A)  $DACBE$                       (B)  $ABCDE$                       (C)  $BDACE$   
 (D)  $BCDAE$                       (E)  $DCABE$

3. Ermali ka 20 topa me ngjyra të ndryshme të verdha, jeshile, blu ose të zeza. Nga këto, saktësisht 17 nuk janë jeshile, 15 nuk janë të zeza dhe 12 nuk janë të verdha. Sa topa blu ka Ermali?

- (A) 8                      (B) 7                      (C) 6                      (D) 4                      (E) 3


4. Në cilin interval ndodhet vlera e  $88 \times 888$ ?

- (A) Ndërmjet 8 dhe 88                      (B) Ndërmjet 88 dhe 888                      (C) Ndërmjet 888 dhe 8 888  
 (D) Ndërmjet 8 888 dhe 88 888                      (E) Ndërmjet 88 888 dhe 888 888

5. Sa është rrënja katrore e  $16^{16}$ ?

- (A)  $4^4$                       (B)  $4^8$                       (C)  $4^{16}$                       (D)  $8^8$                       (E)  $16^4$

6. Format e paraqitura më poshtë janë tre format e para të një vargu. Sa pika përmban forma e pestë në varg?



- (A) 72                      (B) 74                      (C) 76                      (D) 78                      (E) 80

7. Marku merr numrin  $x$  duke pjesëtuar  $\sqrt{11}$  me tre. Në cilin interval të drejtëzës numerike ndodhet  $x$ ?


- (A) Ndërmjet 0 dhe 1                      (B) Ndërmjet 1 dhe 2                      (C) Ndërmjet 2 dhe 3  
 (D) Ndërmjet 3 dhe 4                      (E) Ndërmjet 4 dhe 5

8. Çokollata e preferuar e Silvës vjen në pako. Çdo pako përmbante pesë kuti çokollate. Tani ato përmbajnë vetëm katër kuti por shiten me të njëjtin çmim. Me sa përqind është rritur çmimi i çdo kutie?


- (A) me 10%      (B) me 20%      (C) me 25%      (D) me 30%      (E) me 50%

9. Roberti dëshiron të zgjedhë katër pika në mënyrë që distancat midis çdo çifti pikash të jenë të ndryshme. Cila nga pikat  $A$ ,  $B$ ,  $C$ ,  $D$  dhe  $E$  duhet të hiqet?

- (A)  $A$       (B)  $B$       (C)  $C$       (D)  $D$       (E)  $E$




10. Në planin  $xy$ , në zonën e përcaktuar nga  $0 \leq x \leq 1$ ,  $0 \leq y \leq 1$ , disa pika janë lyer me të zezë. Pika  $(x, y)$  është e lyer me të zezë nëse si për  $x$  ashtu edhe për  $y$ , shifra e parë pas presjes dhjetore është numër tek. Si duket zona pas këtij veprimi?



Problema me 4 pikë

11. Katër rrahë me rreze  $r_1$ ,  $r_2$ ,  $r_3$  dhe  $r_4$  i kanë qendrat në pikat  $(0,0)$ ,  $(1,0)$ ,  $(3,0)$  dhe  $(6,0)$ . Ato mund të jenë tangente, por nuk priten. Sa është vlera më e madhe e mundshme e  $r_1 + r_2 + r_3 + r_4$ ?




- (A) 3      (B) 4      (C) 5      (D) 6  
 (E) nuk ka kufi të sipërm

12. Ndërmjet 10 numrave natyrorë të ndryshëm, pesë janë të pjesëtueshëm nga 5 dhe shtatë janë të pjesëtueshëm nga 7. Le të jetë  $M$  më i madhi nga këta numra. Cila është vlera më e vogël e mundshme e  $M$ ?

- (A) 105      (B) 77      (C) 75      (D) 63      (E) një vlerë tjetër


13. Harta tregon një lagje që ka 4 shkolla. Ajo tregon edhe zonat A, B, C dhe D të të gjitha pikave më të afërta, përkatësisht, me çdo shkollë. Koordinatat e shkollës në zonën D janë (9, 1). Cilat janë koordinatat e shkollës në zonën A?

- (A) (0, 4)                      (B) (1, 4)                      (C) (1, 5)  
 (D) (1, 6)                      (E) (2, 4)



14. Diagrami tregon një çerekrrësh  $OPQ$  dhe një trekëndësh  $OPR$ . Dy zonat gri kanë të njëjtën syprinë. Sa është gjatësia e  $OR$ ?

- (A)  $\frac{\pi r}{2}$                       (B)  $\frac{3r}{2}$                       (C)  $\pi r$                       (D)  $\frac{2}{\pi}$                       (E)  $\frac{\pi}{2r}$




15. Cili është numri natyror më i vogël  $N$  i tillë që  $\sqrt{2\sqrt{3\sqrt{N}}}$  të jetë numër i plotë?

- (A)  $2^{12} \cdot 3^6$                       (B)  $2^4 \cdot 3^{14}$                       (C)  $2^4 \cdot 3^6 \cdot 5^8$                       (D)  $2^4 \cdot 3^2$                       (E) asnjë nga këto

16. Në një tabelë shahu gjigante  $4 \times 4$  ka 16 kangurë, një në çdo katror. Çdo herë, secili nga kangurët kërcen në një katror fqinj (lart, poshtë, majtas ose djathtas, por jo diagonalisht), por nuk dalin jashtë tabelës. Në çdo katror mund të ketë disa kangur. Pas 100 herëve, sa është numri më i madh i mundshëm i katrorëve bosh?


- (A) 15                      (B) 14                      (C) 12                      (D) 10                      (E) 8



17. Numri pesëshifror  $\overline{N18NN}$  pjesëtohet me 18. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë për shifrën  $N$ ?

- (A) Ekziston saktësisht një  $N$  e tillë                      (B) Ekzistojnë saktësisht dy  $N$  të tilla  
 (C) Ekzistojnë saktësisht tre  $N$  të tilla                      (D) nuk ekziston asnjë  $N$   
 (E) Ka më shumë se tre  $N$  të tilla

18. Një nxënës vizatoi grafikët e dy funksioneve lineare në një sistem koordinativ, siç tregohet në figurë.




Shprehja  $ab + cd - (ac + bd)$  është gjithmonë

- (A) negative.                      (B) jo pozitive.                      (C) pozitive.  
 (D) zero.                      (E) asnjëra nuk është gjithmonë e vërtetë.

19. Syprina e gjysmërrethit të zi është  $12 \text{ cm}^2$ . Sa është syprina e çerek rrethit të madh?

- (A)  $42 \text{ cm}^2$     (B)  $36 \text{ cm}^2$     (C)  $32 \text{ cm}^2$     (D)  $30 \text{ cm}^2$     (E)  $25 \text{ cm}^2$




20. Kur gjyshja filloi të thurte çorape leshi, ajo kishte një top të madh fije me diametër  $30 \text{ cm}$ . Pas mbarimit të  $70$  çorapeve, topi i fijeve të mbetur e kishte diametrin  $15 \text{ cm}$ . Sa çorape të tjera thurr gjyshja me fillin që ka mbetur?

- (A) 70    (B) 50    (C) 30    (D) 20    (E) 10



Problema me 5 pikë

21. Një nxënës ka shkruar dy numra në tabelë. Më pas ai i fshin ato dhe shkruan shumën dhe diferencën pozitive të këtyre numrave. Ai e vazhdon këtë proces me numrat e rinj. Ai fillon me numrat  $3$  dhe  $5$  dhe e përsërit procesin  $50$  herë. Cilët janë dy numrat që merr ai në fund?




- (A)  $3^{25}$  dhe  $5^{25}$     (B)  $3^{50}$  dhe  $5^{50}$     (C)  $2 \cdot 3^{25}$  dhe  $2 \cdot 5^{25}$   
 (D)  $3 \cdot 2^{25}$  dhe  $5 \cdot 2^{25}$  (E) pasnjëra nga këto

22. Gjeni shkroi një numër të plotë dyshifror në një dërrasë të zezë. Pastaj, ai fshiu shifrën e fundit të numrit të plotë. Si rezultat, numri i plotë fillestar u zvogëlua me  $p\%$ . Cila nga sa vijon është më afër vlerës më të madhe të mundshme të  $p$ ?

- (A) 10    (B) 50    (C) 90    (D) 95    (E) 99

23. Një grup prej tre burrash katrorë nga Marsi dhe një grup prej tre burrash rrethorë nga Jupiteri janë ulur rreth një tavoline, siç tregohet në figurë. Njëri prej tyre ka çelësin e disqeve të tyre fluturuese. Të gjithë anëtarët e një grupi gjithmonë thonë të vërtetën dhe të gjithë anëtarët e grupit tjetër gjithmonë gënjejnë. Të gjashtëve iu bë pyetja "A e ka çelësin një person që ulet pranë jush?". Përgjigjet e tyre janë paraqitur në figurë. Kush e ka çelësin?




- (A) A    (B) B    (C) C    (D) D    (E) E

24. Xhulia dhe motra e saj e vogël Paula dalin së bashku për një xhiro me biçikletë. Të dyja udhëtojnë me një shpejtësi konstante: Xhulia me  $18 \text{ km/orë}$  dhe Paula me  $12 \text{ km/orë}$  dhe përshkojnë të njëjtën rrugë. Xhulia ndihet e lodhur pas  $20$  minutave dhe vendos të kthehet. Kur takon Paulën, Xhulia i thotë të kthehet dhe të dyja kthehen në shtëpi, secila me shpejtësinë e vet. Sa minuta më vonë se Xhulia do të arrijë Paula në shtëpi?


- (A) 4    (B) 6    (C) 8    (D) 10    (E) 15

25. Në një gjysmërreth me diametër  $AD$ , pikat  $B$  dhe  $C$  shtrihen në diametër dhe pikat  $E, F, G$  dhe  $H$  shtrihen në harkun e gjysmërrethit. Sa trekëndësha mund të formohen me kulmet e tyre në tre nga këto tetë pika?



- (A) 15      (B) 50      (C) 51      (D) 52      (E) 54

26. Diagrami tregon një gjashtëkëndësh të rregullt  $ABCDEF$ . Pika  $P$  shtrihet mbi  $BC$  në mënyrë që syprina e  $\triangle PEF$  të jetë  $64 \text{ cm}^2$  dhe syprina e  $\triangle PDE$  të jetë  $42 \text{ cm}^2$ . Sa  $\text{cm}^2$  është syprina e  $\triangle APF$ ?




- (A) 53      (B) 54  
 (C) 56      (D) 60  
 (E) 64

27. Secila prej tre kutive përmban tre topa. Mbishkrimet në kapakë tregojnë përmbajtjen e secilës kuti. Kapakët janë vendosur në mënyrë që të mos tregojnë përmbajtjen e saktë të kutisë.

Majku zgjedh një kuti, nxjerr rastësisht një top prej saj dhe shënon ngjyrën e tij pa e kthyer atë. Cili është numri më i vogël i topave që Majku duhet të nxjerrë për të përcaktuar përmbajtjen e secilës kuti?

- (A) 0      (B) 1      (C) 2      (D) 3      (E) 4

28. Figura tregon një tetëkëndësh të rregullt me brinjë 1 cm. Me qendër në çdo kulm është vizatuar një hark me rreze 1 cm, siç tregohet. Sa është perimetri i zonës me gri?



- (A)  $\pi \text{ cm}$       (B)  $\frac{2\pi}{3} \text{ cm}$       (C)  $\frac{8\pi}{9} \text{ cm}$   
 (D)  $\frac{4\pi}{5} \text{ cm}$       (E)  $\frac{3\pi}{4} \text{ cm}$


29. Brikena ka shkruar një numër në secilë kuti të një tabele  $7 \times 10$ . Shuma e të gjithë numrave në çdo drejtkëndësh  $3 \times 4$  ose  $4 \times 3$  është zero. Numrat në dy nga kutitë tregohen në diagram. Sa është shuma e të gjithë numrave në tabelë?

				20	25				

- (A) -5      (B) -20      (C) -25  
 (D) -45      (E) nuk është e mundur të përcaktohet



30. Brinjët  $AB$  dhe  $CD$  të katërkëndëshit i mysët (konveks)  $ABCD$  ndahen secila në tre pjesë nga pikat  $E, F, P$  dhe  $Q$  në mënyrë që  $AE = EF = FB$  dhe  $DP = PQ = QC$ .



Diagonalet e  $AEPD$  dhe  $FBCQ$  priten përkatësisht në pikat  $M$  dhe  $N$ . Syprinat e trekëndëshave  $AMD$ ,  $EMP$  dhe  $FNQ$  janë përkatësisht 154, 112 dhe 99. Sa është syprina e trekëndëshit  $BCN$ ?

(A) 57

(B) 70

(C) 72

(D) 86

(E) 141